



NJOFTIM PËR SHTYP

RAPORTI I RI ANALIZON INTEGRITETIN E POLICISË DHE TË INSTITUCIONEVE PROKURORIALE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Raporti i ri nga Iniciativa Globale kundër Krimet të Organizuar Transnacional (GI-TOC) eksploron sfidat me të cilat përballen policia dhe institucionet e prokurorisë në Ballkanin Perëndimor. I titulluar *Integriteti dhe Pavarësia e Institucioneve të Drejtësisë Penale në Ballkanin Perëndimor: Policia dhe Prokuroria*, raporti ofron një analizë gjithëpërfshirëse të ndikimeve politike dhe atyre të jashtme që minojnë pavarësinë dhe efektivitetin e policisë dhe shërbimeve të prokurorisë në rajon.

Duke ndërtuar mbi punën e GI-TOC në Ballkanin Perëndimor, ky raport i tretë në *seritë e Korrupsionit të Organizuar* trajton se si ndërhyrja politike, mungesa e pavarësisë operationale, mungesa e bashkëpunimit ndërkombëtar, rajonal dhe dypalësh, si dhe korrupsioni i organizuar sistematik krijojnë dobësi brenda policisë dhe institucioneve të prokurorisë. Studimi zbulon nevojën kritike për mekanizma më të fortë qeverisjeje, rritje të qëndrueshmërisë individuale dhe organizative ndaj presionit politik, më shumë edukim kundër korrupsionit, si dhe transparencë më të madhe në proceset e emërimit dhe promovimit të zyrtarëve të zbatimit të ligjit. Edukimi themelor dhe trajnimi i vazhdueshëm në vendin e punës për standardet etike, të cilat ndihmojnë në ndërtimin e një sistemi të besueshëm profesional të rrënjësor në integritet dhe pavarësi, identifikohen si një nga mekanizmat më efektivë për të forcuar qëndrueshmërinë.

Një gjetje kyçe e raportit është se presioni politik ndihet më së shumti në vendimet që lidhen me hetimet, emërimet dhe ngritjet në detyrë të profileve të larta, duke dobësuar aftësinë e institucioneve (veçanërisht të organeve të specializuara) për të vepruar në mënyrë të pavarur. Kjo minon besimin e publikut dhe përforcon ciklin e mosndëshkimit për ata që janë të përfshirë në krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Raporti thekson sfidat specifike të secilit prej gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Raporti thekson se si përfaqësimi i femrave në polici mbetet i ulët në shumë vende të Ballkanit Perëndimor, shpesh nën standardet e BE-së. Edhe pse ka barazi më të madhe gjinore në rolet prokuroriale, prania e grave në pozita drejtuese si në polici ashtu edhe në shërbimet e prokurorisë mbetet shumë e kufizuar. Kjo pabarazi thekson nevojën për t'i dhënë përparësi barazisë gjinore në nivele më të larta institucionale për të siguruar një sistem drejtësie të ekuilibruar dhe efektiv, të aftë për të përfaqësuar popullsinë e çdo vendi përkatës.

Raporti bën thirrje për masa strategjike për të forcuar pavarësinë e institucioneve të drejtësisë penale, duke përfshirë reformat në sistemet e emërimeve, përmirësim të mekanizmave të mbikëqyrjes dhe rritjen e angazhimit me akterët e shoqërisë civile për të monitoruar dhe mbështetur llogaridhënien.

Raporti i radhës, i planifikuar të publikohet në vitin 2025, do të vazhdojë këtë studim katër-pjesësh duke u fokusuar në gjyqësorin dhe autoritetet kundër korrupsionit në rajon.

MBI "INICIATIVËN GLOBALE" (GI-GOC)

Iniciativa Globale kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar është rrjet profesionistësh që punojnë në frontin e luftës kundër ekonomisë së paligjshme dhe faktorëve kriminalë. Falë një rrjeti vëzhguesish globalë të shoqërisë civile në lidhje me ekonominë e paligjshme, ne monitorojmë prirjet e ndryshimit dhe punojmë për të krijuar bazën e provave për veprim politik, për të shpërndarë ekspertizën e rrjetit tonë dhe për të nxitur reagimet shumësektoriale dhe holistike ndaj një game të gjerë të llojeve të krimin. Me "Fondin e Qëndrueshmërisë" të Iniciativës Globale, ne mbështetim aktivistët e komunitetit dhe organizatat joqeveritare lokale që punojnë në fusha ku qeverisja kriminale vë në rrezik të madh sigurinë dhe mbrojtjen e njerëzve dhe mundësitë e tyre në jetë.

RRETH OBSERVATORIT TË EKONOMIVE TË PALIGJSHME NË EVROPËN JUGLINDORE (SEE-OBS)

Observatori është platformë që bashkon dhe fuqizon aktorët e shoqërisë civile në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Shqipëri. Qëllimi i Observatorit është t'i mundësojë shoqërisë civile të identifikojë, të analizojë dhe të vendosë në hartë prirjet kriminale dhe ndikimin që ato kanë në prurjet e paligjshme financiare, qeverisje, zhvillim, marrëdhëniet ndëretnike, sigurinë dhe shtetin ligjor, dhe ta përkrahë shoqërinë civile në monitorimin e dinamikave kombëtare dhe prirjeve rajonale e ndërkombëtare të krimin të organizuar. Observatori u themelua si rezultat i Samitit të vitit 2018 të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Londër, në kuadër të Procesit të Berlinit.

Për të mësuar më shumë ose për të intervistuar autorët e raportit, mos ngurroni t'i shkruani Klaudio Landit (Claudio Landi) në adresën e emailit: claudio.landi@globalinitiative.net.

